



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Departament

DATE	26.05.2023
REFERENCË	
PËR/ZATTO:	Znj. Feride Podvorica, Zv. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Drejtësisë
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve Daneze

E nderuara znj. Podvorica,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor të Projektligjit për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve Daneze, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Drejtësisë (MD), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Departamenti i Buxhetit paraqet:

#### ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë Traktatit Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve Daneze, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë të të dy vendeve me 26 prill 2022 në Prishtinë dhe me 16 maj 2022 në Kopenhagë.

OPINIONI I PARAPARË I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E  
NDIKIMIT TË SHPENZIMEVE

Ministria e Drejtësisë si organ propozues, ka përcaktuar vlerësimin e ndikimit buxhetor të sipas të cilit vlerësohet që ndarjet buxhetore për nën programin Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK) të parapara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2024-2026 për zbatimin e këtij projektligji janë në shumë prej 30,228,750 euro, të shpërndara për vite dhe kategori të shpenzimeve si në vijim:

Vitet	2024	2025	2026	Totali
Numri i punëtorëve	113	113	113	113
Pagat dhe Shtesat	1,500,000	1,575,000	1,653,750	4,728,750
Mallrat dhe Shërbimet	1,500,000	1,500,000	1,500,000	4,500,000
Shpenzimet Kapitale	7,000,000	13,000,000		21,000,000
Totali	10,000,000	17,075,000	3,153,750	30,228,750

Kjo marrëveshje ka për qëllim të rregulloji çështjet që kanë të bëjnë ose që rrijnë nga ekzekutimi i dënimeve daneze me burg, dhe përcakton kushtet e nevojshme gjatë ekzekutimit të dënimeve daneze, përfshirë çështjet lidhur me azilin në shtetin pranues, si dhe procedurën, të drejtat dhe detyrimet e të dyja palëve.


Bazuar në nenin 32 të traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për shfrytëzimin e Institucionit korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve Daneze është paraparë të paguhet një tarifë në shumë prej 15,000,000 euro për çdo vit nga momenti i shfrytëzimit të hapësirave të Institucionit korrektues në Gjilan nga Mbretëria e Danimarkës me qëllim të ekzekutimit të dënimeve Daneze.

**Përfundim:**

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Ratifikimin e Traktatit Ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës për Shfrytëzimin e Institucionit Korrektues në Gjilan me qëllim të ekzekutimit të dënimeve Daneze nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke nënkuptuar që gjatë zbatimit të këtij projektligji të gjitha aktivitetet do të mbulohen nga ndarjet buxhetore të parapara me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitet 2024-2026 për Ministrinë e Drejtësisë konkretisht nën programin Shërbimi Korrektues i Kosovës i cili do ta zbaton në praktikë këtë projektligji.

Përgatitur nga:

Gezim Bislimi, Analist i lartë e buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

